

# NDIKIMI I INTERNETIT DHE VIDEOLOJËRAVE NË (MOS)NXËNIEN E SHQIPES TE FËMIJËT PARASHKOLLORË NË RMV

Ajten HAJDARI-QAMILI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Universiteti "Shën Kirili e Metodi" – Shkup,

\*Fakulteti i Filologjisë, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

ajten15@icloud.com

---

## Abstrakti

Përgjatë këtyre 10-20 viteve të fundit, interneti dhe sistemet e rrjeteve sociale janë bërë gjithnjë e më popullore dhe janë futur në jetën e njerëzve në shumë mënyra. Këto faqe janë konsideruar si çerdhe e medias sociale, sidomos YouTube dhe videolojërat si faqe më me ndikim në zhvillimin e fëmijëve. Efektet negative të internetit pasqyrohen edhe te shpërfillja e shqipes nga fëmijët shqiptarë, sepse gjeneratat e reja më parë e mësojnë anglishten, sesa shqipen dhe po asimilohen duke jetuar në trojet autoktone shqiptare. Kjo dukuri që hapëron me hapa shumë të shpejta, rrezikon që për një periudhë të shkurtër të shuhemi si komb.

**Qëllimi** i këtij hulumtimi është të analizojë dhe të vërtetojë se si po ndikon interneti dhe videolojërat në nxënien ose mosnxënien e shqipes nga fëmijët parashkollorë në RMV.

**Metodat** që janë shfrytëzuar për këtë hulumtim, janë metoda e anketimit dhe analizës. Të dhënat janë mbështetur në rezultatet e mbledhura nga pyetësi që ua kam shpërndarë edukatoreve të çerdheve në vendbanimet shqiptare të RMV-së dhe prindërve të fëmijëve parashkollorë. Gjithsej kanë marrë pjesë 80 prindër të fëmijëve të moshave prej 2-6 vjeç dhe 9 edukatore.

Nga ky hulumtim erdhëm në **përfundim** se në rrjetet sociale përveç që shfaqet një numër i konsiderueshëm i llojeve të dhunës kibernetike, si: talljet, ngacimi seksual, shantazhimi me fotografat, kërcënime të ndryshme, varësia nga interneti, privimi nga gjumi i shëndetshëm etj., shfaqet edhe një dukuri tjetër shumë e dhimbshme që po përhapet te fëmijët shqiptarë, e ajo është se nuk arrijnë ta mësojnë gjuhën e tyre amtare, ngaqë rriten duke dëgjuar më shumë anglishten, sesa shqipen. Fëmijët 2-6 vjeç në familjet 100% shqiptare flasin anglisht, gjegjësisht dëgjojnë prindërit shqip, por u përgjigjen anglisht ose gërshetojnë fjali me fjalë shqipe dhe anglishte, kurse nëpër çerdhe apo në park fëmijët mes vete flasin anglisht.

---

## Hyrje

Interneti çdo ditë e më shumë po ua lehtëson njerëzve mënyrën e zhvillimit, shfaqjen e mendimeve dhe ideve të ndryshme dhe shpërndarjen e artikujve a përmbajtjeve të shumëllojshme. Në fillim interneti është paraqitur si një rrjet kompjuterik jashtëzakonisht i vogël, por me kalimin e kohës është përhapur me shpejtësi të madhe për shkak të lidhjes së mjeteve të komunikimit, i cili ndikoi në lehtësimin e jetës sonë. U deshën gati 30 vjet që radioja të përhapej në 60 milionë njerëz në Shtetet e Bashkuara. Televizori e bëri këtë për 15 vjet, kurse teknologjia e internetit e arriti këtë brenda 3 viteve, pas zhvillimit të rrjeteve kompjuterike në mbarë botën.<sup>79</sup>

---

<sup>79</sup> Manuel Castells, *Aç Toplumunun Yükselişi*, İstanbul, 2013, f. 30-36.

Konsiderohet se edhe faqet që u ofrojnë fëmijëve të vegjël argëtim, janë rritur në mënyrë drastike në vitet e fundit. Një pjesë e madhe e zhvillimit shoqëror dhe emocional të këtij brezi ndodh teksa ata përdorin internetin.

Kudo në botë, prindërit, mësimitdhënësit dhe punonjësit shëndetësorë po shprehin shqetësim mbi ndikimin e medias sociale te fëmijët. Si mjet, interneti është bërë thikë me dy presa, e cila përderisa bart më vete shumë të mira e përparësi, njëkohësisht edhe po dëmton fëmijët e të rinjtë. Për t'i mbrojtur fëmijët nga anët negative të internetit rol të rëndësishëm luan mjedisi familjar dhe institucionet.

Mjedisi familjar ka një rëndësi thelbësore për edukimin e fëmijëve në të gjitha aspektet e jetës, përfshirë këtu edhe kulturën gjuhësore, qoftë e një apo më shumë gjuhëve. Fëmijët e vegjël përdorin të gjitha shqisat e tyre, shikimin, prekjen, dëgjimin, nuhatjen, shijimin, teksa ndërveprojnë me mjedisin përreth dhe mësojnë në të. Komplexiteti i mjedisit familjar kombinuar me këtë përvojë multishqisore mundëson kategorizimin e mjediseve familjare. Për këtë arsye, është e rëndësishme që dimensionet e mjediseve familjare të maten dhe të përdoren si indikatorë zhvillimi në studimet për fëmijët.<sup>80</sup>

Pikërisht, në këtë mjedis ndodhin të gjitha aktivitetet zhvilluese (ose penguese të zhvillimit – kur mjedisi ka probleme), të cilat afektojnë atë që Vygostky e quajti qasja interaksioniste. Një nga komponentët më të rëndësishëm të një mjedisi mbështetës është praktika prindërore për t'u lexuar fëmijëve me zë që nga mosha e hershme.<sup>81</sup>

Të gjitha aktivitetet lexuese si dhe aktivitete të tjera ndërvepruese me fëmijët si tregimi i përrallave, këndimi i këngëve, lojërat me shkronja e me fjalë, po ashtu edhe besimet dhe sjelljet e prindërve ndaj leximit dhe të dhënat e tyre demografike përbëjnë mjedisin letrar familjar. Studimet kanë treguar se ka një marrëdhënie pozitive ndërmjet mjedisit letrar familjar dhe aftësive gjuhësore të fëmijëve.<sup>82</sup>

Hart-i dhe Risley<sup>83</sup> analizuan ndryshimet e mirëqenies, mes klasës punëtore dhe familjet me prindër intelektualë. Ata raportuan se ndryshimi në sasinë e të folurit në familje është shumë i madh dhe ky ndryshim i shtohet avantazheve ose disavantazheve të shumta për fëmijët në përvojat gjuhësore përpara se ata të fillojnë shkollën. Një nga zbulimet e tjera më të rëndësishme të tyre ishte gjetja se sasia e bisedave që ndodh në familje, veçanërisht bisedat shoqërore, kishin një lidhje të rëndësishme me ndryshimet e mëdha në pasurimin e fjalorit të një fëmije dhe arritjeve të tij.

Gonzales-i dhe kolegët e tij<sup>84</sup> studiuuan marrëdhënien mes mjedisit letrar familjar dhe pritshmërisë së pretenduar të prindërve si parashikues të fjalorit të kuptuar dhe atij të shprehur te fëmijët parashkollorë. Ata arritën në përfundimin se, sa më i zhvilluar është mjedisi letrar familjar, aq më pozitive ishin pritshmëritë e prindërve. Këto të fundit, nga ana tjetër, lidheshin me rezultate më të larta të fjalorit shprehës të fëmijës.

---

<sup>80</sup> Iltus, S. (2006) Significance of home environments as proxy indicators for early childhood care and education.

<sup>81</sup> Po aty.

<sup>82</sup> Weigel, D. J, Martin,S.S.and Bennet ,K.K 2006 Contributions of the home Literacy Environment to Preschool Aged children 's Emerging literacy and Language Skills . Early Child Development and Care 176, 357-378

<sup>83</sup> Hart,B.,and Risley T.R (2003).

<sup>84</sup> Gonzalez ,J.E.,Rivera,V.Y.,Davis,M.J and Taylor , A.B. (2010.)Foundations of Young Children'S Vocabulary Development, The role of the Home Literacy Environment HIL. Early childhood Service ,4, 69,86.

Një tjetër element i rëndësishëm i mjedisit letrar familjar është edhe të shkuarit në bibliotekë ose librari me fëmijën. Sénéchal dhe koleget e saj<sup>85</sup> arritën në përfundimin se fëmijët që vizitonin librari ose bibliotekë me prindërit kërkonin t'u lexohej libra më shpesh. Gjithashtu, u gjet një korrelacion domethënës pozitiv mes ekspozimit të fëmijëve ndaj librave dhe nivelit të fjalorit të tyre. Ato erdhën në përfundim se ekspozimi ndaj librave përbën një parashikues unik për fjalorin e fëmijëve parashkollorë. Në studimet e mëvonshme, Sénéchal hulumtoi më thellë duke zbuluar se mjedisi i pasur letrar familjar dhe ekspozimi i fëmijëve ndaj librave rrit jo vetëm fjalorin e tyre, por edhe dijen e tyre fonologjike.<sup>86</sup> Në këtë studim, ekspozimi i fëmijëve ndaj librave nuk do të thoshte domosdoshmërisht se prindërit u jepnin atyre instruksione të mësimi të gjuhës apo fjalëve të shkruara. Kështu, ata theksuan se fëmijët do të mësonin të njihnin pjesërisht shkronjat dhe tekstet edhe në një mënyrë pasive.<sup>87</sup>

Përveç kësaj, leximi i përsëritur i librave me tregime e përralla do të përmirësojë fjalorin e fëmijës dhe do t'i mundësojë ata të bëjnë lidhjen mes fjalëve të shkruara dhe fjalëve të folura. Është e rëndësishme që prindërit të lexojnë me fëmijët e tyre dhe jo për fëmijët e tyre, çka do të thotë se ata duhet t'i përfshijnë fëmijët aktivisht në procesin e leximit dhe jo t'i lënë ata thjesht si dëgjues pasivë .

Së fundi, sipas Sénéchal dhe LeFevre,<sup>88</sup> ka dy mënyra se si mund të ndërtohet një ambient letrar i përshtatshëm për zhvillimin e aftësive të shkrimit dhe leximit në shtëpi: 1) informal – ekspozimi ndaj librave dhe 2) formal – diskutimi dhe përqendrimi eksplisit mbi materialet e shkruara (librat, tekstet) të prindërve dhe fëmijëve.

Të njëjtin funksion të mjedisit letrar familjar e ka edhe mjedisi letrar në institucion. Institucionet e edukimit dhe arsimit parashkollor janë çerdhet. Në çerdhe, ku në të vërtetë fëmijët kalojnë pjesën më të madhe të ditës së tyre, mjedisi letrar dhe posaçërisht leximi është shumë i rëndësishëm. Studiuesit kanë dëshmuar se edhe duke u lexuar me zë fëmijëve në klasa apo ambiente grupi, mund të kontribuohet në përshpejtimin e zhvillimit të tyre gjuhësor.<sup>89</sup>

Institucioni mundet gjithashtu të plotësojë mangësitë e mjedisit letrar në familje. Studimet e zhvilluara me fëmijë nga familje me të ardhura të ulëta treguan se pavarësisht nga mjediset e tyre familjare ofrimi i leximit me zë në klasë dhe sidomos ofrimi i leximit interaktiv ndikoi në përmirësimin e zhvillimit të tyre gjuhësor. Fëmijët mësuuan fjalë të lidhura me aktivitetet e prezantuara gjatë leximeve nga mësuesit e trajnuar për këtë qëllim. Megjithëse leximi në grup nuk mund të ketë të njëjtin efekt me leximin një me një (prind-fëmijë), ai sërish është një mënyrë për t'u mësuar fëmijëve fjalë të reja. Siç zbuluan Hart-i dhe Risley, t'u mësuash fëmijëve gjuhën dhe fjalorin në moshë të hershme i ndihmon ata të krijojnë aftësi të cilat do të vazhdojnë t'i zhvillojnë gjatë jetës.<sup>90</sup>

---

<sup>85</sup> Senchal , M.,Le Fevre,J.A,Hudson ,E.,dhe Lawson E. P (1996).Knowledge of Storibooooks as a Perdictor of Young Childrens Vocabulary.Jourunal of Educational Psychology . f. 88, 520-536

<sup>86</sup> Senechal ,M. ,LeFevre,J.A.,Thomas , E .M , dhe Daley K.E 1998 Differential Efect of Home Literacy Experiences on the Development of Oral and vrite Lnguage .Reading Research Quarterly 33, 97- 116

<sup>87</sup> Sigelman,C.K Rider , E.A. (2003) cit f.330

<sup>88</sup> Senechal , M.,dhe Fe Lever , J.A., (2002). Paretal Involvment in the Development of Children'sReading Skills A Five Yare Longitudinale Study.Child Developent f.73, 445- 460

<sup>89</sup> Ouein,H,Bahues R, dhe Nabhani ,M (2008) Inpact of Read aloud the C lassroom A Case Study .The Reading and Language Development in Preschool Classrooms.Journal of Educational Psychology 98,63-74.

<sup>90</sup> Po aty.

Nëse e vëmë në përqsaje krejt atë që e thamë më sipër për mjedisin letrar familjar dhe institucional, kundrejt përrallave, filmave vizatimorë dhe videolojërave nga interneti, do të shohim se këto të fundit janë shumë më të përhapura kohëve të fundit dhe se me vete, përpos rezultateve pozitive, bartin edhe shumë efekte negative, përfshirë këtu edhe kulturën gjuhësore të fëmijëve.

Vuk Vučetić-i, doktor i shkencave të komunikimit, thotë se videolojërat kryesisht perceptohen si dukuri negative, megjithëse ndikimi negativ në zhvillimin e fëmijëve kurrë nuk është dëshmuar plotësisht. Duke përmendur shembullin e lojës GTA, e cila i ka karakteristikat e saj negative, siç është promovimi i dhunës, krimin etj. Vučetić thotë se kjo lojë po ashtu u ndihmon fëmijëve të zhvillojnë shkathtësi më të mira motorike, gjindshmëri në hapësira të panjohura, përdorim të hartave gjeografike etj. Ai thotë se, do të ishte joserioze të përshkruhej potenciali i videolojërave në kontekstin e zhvillimit të njohurive mediale. Teknologjitë e reja, të mençura po zhvillohen nga dita në ditë dhe videolojërat janë më të pranishme se kurrë më parë. Videolojërat të cilat mund të merren me telefona të mençur mund të jenë të dobishme për zhvillimin e njohurive mediale. Lojërat që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve matematikore, si dhe lojërat që përfshijnë njohjen me ligjet themelore të fizikës janë tejet të popullarizuara dhe të dobishme për audiencën më të re.

Megjithatë, Vučetić-i shton se megjithëse ato quhen lojëra dhe shërbejnë për argëtim, do të ishte thjeshtësim i madh të thuhej se ato si të tilla janë të parrezikshme dhe se prindërit nuk do të duhej t'i perceptojnë teknologjitë e reja si lodra të cilat duhet ta plotësojnë kohën e lirë të fëmijëve, por çdo ditë duhet të kontrollojnë se çfarë informatash dhe vlerash i ofron loja fëmijës së tyre.

Përveç këtyre rreziqeve, te fëmijët shqiptarë si efekt negativ i filmave vizatimorë dhe videolojërave nga interneti është shpërfillja e gjuhës amtare shqipe. Mungesa e mjesisit letrar familjar dhe zëvendësimi i saj me internetin, ka bërë që fëmijët e sotëm në RMV të mos arrijnë të mësojnë shqipen si duhet, madje ta lënë nën hijen e anglishtes. Ata qëkur fillojnë të shqiptojnë fjalët e para, së pari thonë fjalë anglisht më pas duke e shoqëruar me fjalën shqipe, bile duke u rritur më së miri shprehen anglisht, sesa shqip.


Për të nxjerrë të dhëna më konkrete për këtë dukuri, anketova gjithsej 80 prindër të fëmijëve të moshave prej 2-6 vjeç dhe 9 edukatore. Nga gjithsej 80 persona të anketuar, 74% janë të gjinisë femërore dhe 26% meshkuj. Sipas nivelit arsimor 22 prej tyre kanë kryer shkollën fillore, 30 shkollën e mesme dhe 28 fakultetin. Nga të gjithë prindërit pjesëmarrës 62 prej tyre janë të punësuar, ndërsa 18 nuk punojnë.

## **Analiza e rezultateve**

Gjatë hulumtimit dhe qëndrimit me fëmijët, vura re se te fëmijet e moshave 2-6 vjeç prania e elementeve të huaja gjuhësore gjatë bisedës janë më të spikatura. Ata përdorin fjalë dhe shprehje nga anglishtja të ndikuara më së shumti nga videolojërat dhe filmat vizatimorë. Ky ndikim ka bërë që ata të mos mund ta shprehin mendimin apo gjendjen e tyre emocionale në gjuhën amtare, por e shprehin anglisht, si p.sh.: *Unë jam shumë "happy"* – (i/e gëzuar, i/e lumtur); kur shprehin habi, thonë *"O my God"* (O Zoti im); kur gëzohen ose arrijnë të plotësojnë dëshirat (synimet) e tyre përdorin shprehjen *"Oh yes"* (oh po, ia dola). Shembuj të tjerë janë edhe këto: *see you* – shihemi, *sorry* - më fal, *come on* – eja, *I have an idea* - kam një ide, *I hate you* - të urrej, *weekend* – fundjavë, *I love you* - të dua, *dream* – ëndërr, *great* – shkëlqyeshëm etj.

Nga pyetësi konstatohet se elementet më të shpeshta që përdoren anglisht janë: numrat nga 1-10; emrat e pemëve dhe perimeve; emrat e kafshëve; përsëritjet. Pastaj nuk përshtasin gjininë e emrit me të mbiemrit; nuk i dallojnë mirë kohët dhe mënyrat foljore; i përsërisin pa nevojë përemrat vetorë, sidomos vetën e parë (unë); nuk i përdorin rasiat e emrave në mënyrën e drejtë; nuk i përshtasin drejt trajtat e shkurtra të përemrave; mbiemrat dhe ndajfoljet zakonisht i përdorin anglisht: *jam chill, je sweet, je in, jemi shumë happy* etj.


Në pyetjen se cilat nga aparatet elektronike më së shumti i përdorin fëmijët parashkollorë dolën këto rezultate:



Në pyetjen se sa orë në ditë qëndrojnë në internet fëmijët parashkollorë dolën këto rezultate:



Në pyetjen se në çfarë gjuhe i ndjekin emisionet dhe videolojërat në internet fëmijët parashkollorë dolën këto rezultate:



## Përfundimi

Nga ky hulumtim erdhëm në përfundim se ndikimi i përrallave, filmave vizatimorë dhe videolojërave nga interneti ka bërë që fëmijët shqiptarë parashkollorë në RMV, të mos arrijnë ta mësojnë si duhet gjuhën e tyre amtare, sepse rriten duke dëgjuar shumë më tepër anglishten, sesa shqipen; më shumë orë kalojnë duke ndejtur në internet, sesa bisedojnë dhe lexojnë libra me prindërit. Në familjet 100% shqiptare fëmijët flasin anglisht, gjegjësisht dëgjojnë prindërit shqip, por u përgjigjen anglisht ose gërshetojnë fjali me fjalë shqipe dhe anglishte, kurse nëpër çerdhe apo në park fëmijët mes vete flasin më shumë anglisht.

Interneti ka ardhur për të qëndruar dhe nuk ka për të ikur, prandaj, ne si shoqëri duhet të gjejmë mënyra se si t'i mbrojmë fëmijët nga potenciali i saj i dëmshëm. Rreziqet që lidhen me privatësinë, shëndetin mendor, kulturën gjuhësore dhe mirëqenien e tyre në përgjithësi, duhet të shkrihen në planet mësimore dhe t'u përçohen edhe prindërve, kujdestarëve dhe edukatorëve. Fëmijëve duhet t'u mësohen procedura efektive për të mbrojtur veten dhe kjo duhet t'u reflektohet duke marrë shembuj nga jeta reale, respektivisht, nga të rriturit.

Aplikacionet dhe softuerët mbrojtës, së bashku me ndalesat e duhura, duhet të aplikohen në rrjetet sociale ashtu që fëmijët të kenë qasje në to dhe në ligjet e rregullat e përgjithshme. Gjithashtu, prindërit duhet të kalojnë më shumë kohë me fëmijët e tyre duke biseduar, duke luajtur dhe duke lexuar përralla e më pak t'ua lënë në dorë telefonat e mençur, tabletin apo laptopin, që kultura e tyre gjuhësore dhe aftësia shprehëse të rritet më shumë në gjuhën shqipe.

Në vijim po japim edhe disa **rekomandime**:

- Mbikëqyr fëmijët përderisa përdorin internetin;
- Kufizo kohën e përdorimit të pajisjeve në internet dhe media sociale;
- Inkurajoni fëmijët të luajnë jashtë për të përmirësuar rezultatet e shëndetit mendor;
- Mësoni rreth teknologjisë dhe sulmeve në internet dhe inkurajoni fëmijët të bëjnë pyetje;
- Mësoni fëmijët si ta mbrojnë privatësinë në internet;
- Mësoni fëmijët të identifikojnë ngacmimet;
- Shpjegojuani fëmijëve që sulmet në internet nuk janë të pranueshme;
- Përfshini aplikacione mbrojtëse në pajisjet elektronike;
- Bisedoni, luani dhe lexoni përralla në shqip me fëmijët tuaj;
- Detyroni fëmijët të shpjegojnë në shqip ngjarje ose të rrëfejnë diçka që kanë parë në internet, duke ua korrigjuar trajtat që ata përdorin gabim;
- Mësojuani fëmijëve faqet e përrallave dhe filmave vizatimorë që janë shqip;
- Mbilluani fëmijëve tuaj në vetëdije dashurinë dhe vlerën e kombit, gjuhës, atdheut dhe traditës shqiptare. Pa gjuhë nuk ka komb, pa komb nuk ka identitet.

### **Literatura e shfrytëzuar:**

- [1]. Akerson, Fatma E.. *Gösterge bilime giriş*. İstanbul: Bilge Kültür Sanat, 2016.
- [2]. Appel, René dhe Pieter Muysken. *Language Contact and Bilingualism*. Amsterdam University Press, 2005.
- [3]. Bakery, Colin dhe Sylvia Prys Jones. *Encyclopedia of Bilingualism and Bilingual Education*. Library of Congress, 1998.
- [4]. Castells, Manuel. *Ağ Toplumunun Yükselişi*. İstanbul: Bilgi Üniversitesi Yayınları, 2013.
- [5]. Crystal, David. *The Fight for English: How language Pundits ate, shot and left*. Oxford: Oxford University Press, 2006.
- [6]. Gonzalez, J. E., Rivera, V. Y., Davis, M. J., & Taylor, A. B. (2010). *Foundations of Young Children's Vocabulary Development: The Role of the Home Literacy Environment (HLE)*. Early Childhood Services, 4, 69-86.
- [7]. Green, C. Shawn dhe Daphne Bavelier. "Action video game modifies visual selective attention". 2003.
- [8]. Iltus, S. (2006) Significance of home environments as proxy indicators for early childhood care and education .
- [9]. Islamaj, Shefkije. *Shqipja standarde dhe modernizimi i saj*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2008.
- [10]. Krasniqi, Visar. "Hi, flm, sps..." - gjuha "moderne" e të rinjve. Tiranë: 2013.
- [11]. Nuhiu, Vesel. *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*. Prishtinë: ASHAK, 2013.
- [12]. Ögel, Kültegin. *Internet Bağımlılığı, İnternetin Psikolojisini Anlamak ve Bağımlılıkla Başa Çıkmak*. Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2012.
- [13]. Oueini, H., Bahous, R., & Nabhani, M. (2008). Impact of Read-Aloud in the Classroom: A Case Study. The Reading Matrix, 8, 139-157.
- [14]. Sénéchal, M., Le Fevre, J.A., Hudson, E., dhe Lawson E. P (1996). *Knowledge of Storybooks as a Predictor of Young Children's Vocabulary*. Journal of Educational Psychology.
- [15]. Sénéchal, M., dhe Le Fevre, J.A., (2002). *Parental Involvement in the Development of Children's Reading Skills A Five Year Longitudinal Study*. Child Development.

- [16]. Sénéchal, M., LeFevre, J.A., Thomas, E.M., dhe Daley K.E (1998) *Differential Effect of Home Literacy Experiences on the Development of Oral and Written Language*. Reading Research Quarterly.
- [17]. Shehu, Hajri. *Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze*. Gjuha jonë 1, 1989.
- [18]. Vehbiu, Ardian. *Leksiku i shqipes, së sotme – sfida të pasurimit*. “Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”. Tiranë: 2011.
- [19]. Xhafa, D., *Language and society in context of globalism*. Korçë: 2013.
- [20]. <https://medium.com/alipay-and-the-world/the-rise-of-digital-life-and-why-you-should-embrace-it-25d69d96a7de>